

POLITIKA E PRIVATËSISË

Slogani ynë është "**TË RËNDËSISHËM JANË NJERËZIT**". Për ne në **HALKBANK AD Skopje** ky slogan do të thotë gjithçka. Parimet tona kryesore janë të ofrojmë shërbime më të mira për klientët tanë, duke u ofruar atyre zgjidhjet më të mira për nevojat e tyre. Për ne, kujdesi ndaj klientit dhe respektimi i privatësisë së tyre, si dhe mbrojtja e të dhënave të tyre personale kur i përpunojmë ato, janë një përparësi kryesore. Kjo politikë e privatësisë shpjegon se çfarë informacioni mbledhim për ju, si dhe përpunimin e të dhënave personale që kryejmë kur vizitoni faqen tonë të internetit dhe/ose kur përdorni ndonjë nga shërbimet tona. Ne në **HALKBANK AD Skopje**, mbledhim vetëm ato të dhëna personale që janë të nevojshme për të kryer aktivitetin tonë në përputhje me ligjin, duke ju ofruar përvojat, produktet dhe shërbimet më të mira të mundshme.

Kush është kontrolluesi i mbledhjes së të dhënave personale dhe si mund të na kontaktoni?

Kontrolluesi i të dhënave personale është **HALKBANK AD Skopje**, me seli në Bulevardin Sh. Qirili dhe Metodi nr. 54 1000 Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut (në tekstin e mëtejshëm: **HALKBANK**).

Mund të na kontaktoni në:

e-mail: halkbank@halkbank.mk

Faqja e internetit: www.halkbank.mk

Telefoni: + 389 (0)2 3240 800;

Kontakt Qendra 24 – Telefoni: +389 (0)2 3296 330; dhe

mund të na ndiqni dhe kontaktoni në:

<http://www.facebook.com/HalkbankADSkopje>

HALKBANK në veprimtarinë e saj është plotësisht e përkushtuar për mbrojtjen e të dhënave tuaja personale që përpunon, si dhe për respektimin dhe mbrojtjen e plotë dhe transparente të privatësisë së personave fizikë – subjekte të të dhënave personale.

HALKBANK i përpunon të dhënat personale në përputhje të plotë me dispozitat e Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, si dhe në përputhje me ligjet e tjera që HALKBANK zbaton në funksionimin e saj, ku në çdo rast respektohen dhe zbatohen të gjitha parimet në lidhje me përpunimin e të dhënave personale të parasjikuara në Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale.

Të dhënat e kujt mbledhim?

Ne mbledhim të dhëna në lidhje me kategoritë e mëposhtme të subjekteve të të dhënave personale (persona fizikë):

- **Vizitues të faqes sonë të internetit** www.halkbank.mk

Ne zakonisht mbledhim të dhëna navigimi (shih më poshtë për më shumë detaje) të cilat përdoren për të analizuar të dhënat nga vizitat në faqen tonë të internetit, si dhe për të ruajtur sigurinë e informacionit të faqes sonë të internetit. Rreth përdorimit të cookies mund të lexoni më shumë në politikën tonë për përdorimin e cookies në lidhjen e mëposhtme.

- **Persona fizikë – përdorues të shërbimeve dhe produkteve të HALKBANK**

Personat fizikë që aplikojnë (përfshi aplikimet online) për një shërbim dhe/ose produkt të caktuar të HALKBANK si p.sh. aplikimi për depozita, kredi, karta, operacione pagese.

Këto kërkesa përmbajnë informacion për identitetin e aplikantit dhe të dhëna personale të personave të tjerë të përfshirë në kërkesën që kërkohen për përpunimin e saj.

Kategoritë e të dhënave që përpunohen

Të dhënat e navigimit

Kur vizitoni faqen tonë të internetit, krijohen regjistra për çdo vizitor me të dhënat e mëposhtme:

Adresa juaj e Protokollit të Internetit (IP);

Pajisja nga e cila po aksesoni, lloji dhe modeli;

Sistemi juaj operativ;

Lloji i shfletuesit, shtojcat dhe versioni;

Faqet që vizitoni në faqen tonë të internetit dhe koha që kaloni në secilën faqe;

URL-ja e faqes që ju ridrejtoi në faqen tonë të internetit dhe në disa raste, termat që keni përdorur në përpjekjen për të gjetur faqen e internetit të HALKBANK;

Gjuha e shfletuesit që po përdorni;

Shteti (i specifikuar përmes adresës IP).

Regjistrat e serverit fshihen automatikisht, përveç nëse rrethanat kërkojnë që ato të mbahen, për shembull për të hetuar një virus ose sulm me qëllim të keq.

Ne në HALKBANK mirëmbajmë në mënyrë të pavarur serverët dhe kryejmë të gjitha aktivitetet në faqen tonë të internetit brenda vendit, duke përfshirë regjistrat që krijohen dhe analizën e të dhënave që transmetohen nga vizitat në faqen tonë të internetit.

Të dhënat që përdoruesit dorëzojnë vullnetarisht

Të dhënat personale që ne mbledhim nga vizita juaj në faqen tonë të internetit, janë ato që ju dorëzoni vullnetarisht për qëllime specifike në përputhje me ligjin, për të na mundësuar të realizojmë aktivitetin tonë në lidhje me çdo shërbim dhe/ose produkt të ofruar nga HALKBANK.

Ne mund të mbledhim cilëndo nga kategoritë e mëposhtme të të dhënave personale: emër dhe mbiemër, adresë banimi, telefon për kontakt dhe e-mail.

Si i mbledhim të dhënat personale?

Ne mbledhim të dhëna personale përmes kanaleve të ndryshme, duke përfshirë:

- nëpërmjet përdorimit tuaj të faqes sonë të internetit, aplikacioneve tona inteligjente, duke përfshirë formularët e aplikimit online;
- nëpërmjet postës sonë elektronike (e-mail): halkbank@halkbank.mk
- nëpërmjet postës,
- drejtpërdrejt në degët dhe ekspoziturat e ХАЛКБАНК.

Kategoritë e përdoruesve të të dhënave personale

Veprimtaritë e përpunimit të të dhënave personale në lidhje me shërbimet online të disponueshme përmes faqes së internetit të HALKBANK AD Skopje i kryejnë punonjësit të cilët janë përgjegjës dhe të autorizuar për këto shërbime ose personat përgjegjës për kryerjen e aktiviteteve në fjalë.

Ne në HALKBANK nuk ndajmë informacion për ju dhe/ose vizitën tuaj në faqen tonë të internetit, palëve të treta, me përjashtim të rasteve të mëposhtme:

- në rast të angazhimit të ofruesve të shërbimeve nëse HALKBANK i punëson ata si përpunues në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale, i cili do t'i detyrojë ata të veprojnë sipas udhëzimeve të marra nga HALKBANK AD Skopje dhe të sigurojnë mbrojtjen e të dhënave personale që përpunohen me rastin e sigurimit të atyre shërbimeve;
- me kërkesë të gjykatës, policisë apo organeve të tjera për të ushtruar kompetencat e tyre dhe vetëm në rastet kur ekziston bazë dhe arsyetim ligjor për këtë.

Koha e ruajtjes së të dhënave të mbledhura

Të dhënat që mbledhim në lidhje me Ju ruhen dhe përdoren në përputhje me ligjin dhe periudhën e kërkuar për të arritur qëllimin e përpunimit. Ne ruajmë informacionin tuaj personal vetëm për aq kohë sa na nevojitet. Sa kohë na duhen të dhënat tuaja personale varet nga ajo për çfarë i përdorim, siç thuhet në këtë politikë të privatësisë. Për shembull, mund të na duhet ta përdorim atë për t'iu përgjigjur pyetjeve tuaja në lidhje me ndonjë produkt ose shërbim, dhe si rezultat ne mund të ruajmë informacione personale ndërsa ju jeni ende duke përdorur produktet ose shërbimet tona. Nëse nuk na duhen më të dhënat tuaja personale, do t'i fshijmë menjëherë ose do t'i bëjmë anonime duke hequr të gjitha detajet që ju identifikojnë. Nëse ne kemi kërkuar dakordimin tuaj për përpunimin e të dhënave tuaja personale dhe nuk kemi bazë ligjore tjetër për të vazhduar me atë përpunim, kurse ju tërhiqni dakordimin tuaj, ne do t'i fshijmë të dhënat tuaja personale përveç rastit kur është caktuar një periudhë më e gjatë me ligj për ruajtjen dhe përpunimin e të dhënave personale. Lista (pasqyra) me afatet për ruajtjen e të dhënave personale është pjesë përbërëse e dokumentacionit për mbrojtjen e të dhënave personale të HALKBANK AD Skopje.

Si e dini se jeni në faqen e internetit të HALKBANK AD Skopje? (pharming prevention)

"Pharming" - një kombinim i fjalëve "phishing" dhe "farming", është një mashtrim në internet që manipulon trafikun e faqes në internet për të vjedhur informacione konfidenciale, duke përfshirë informacionin personal. Në thelb është prodhimi i paligjshëm i një faqe interneti të rreme dhe më pas ridrejtimi i përdoruesve në të. Duke u kujdesur për privatësinë tuaj, ne në HALKBANK aplikojmë masa teknike për parandalimin e këtij lloj kërcënimi. Faqja jonë e internetit përdor domenin halkbank.mk i cili është i regjistruar në Rrjetin e Kërkimeve Akademike të Maqedonisë (MARnet). Prandaj, kur hyni ose shfletoni faqen tonë të internetit dhe veçanërisht nëse lini të dhënat tuaja personale, kontrolloni nëse motori i kërkimit përmban domenin halkbank.mk.

Si i përdorim (përpunojmë) të dhënat tuaja personale?

Ne përpunojmë të dhënat tuaja personale të mbledhura përmes faqes sonë të internetit, aplikacioneve inteligjente dhe kanaleve të tjera të komunikimit vetëm kur kemi një arsye të vlefshme dhe bazë ligjore për këtë. Ne përcaktojmë bazën ligjore bazuar në qëllimet për të cilat mbledhim të dhënat tuaja personale. Megjithatë, ligjshmëria e përpunimit të të dhënave tuaja personale mund të jetë një nga sa vijon:

CPëlqimi/dakordimi: Ne mund të përdorim të dhënat tuaja personale sepse kemi kërkuar pëlqimin/dakordimin tuaj, të cilin mund ta tërhiqni në çdo kohë. Shembujt ku ne kërkojmë pëlqimin tuaj përfshijnë: dërgimin e mesazheve të marketingut kur ju kërkojmë lejen (pëlqimin). Ju mund të tërhiqni pëlqimin/dakordimin tuaj për të marrë këto emaille në çdo kohë duke klikuar lidhjen e çregjistrimit në fund të emailit ose përmes cilësimeve tuaja të emailit.

Për të përmbushur një marrëveshje/kontratë me ju (ose për të ndërmarrë hapa përpara se të lidhmi një marrëveshje/kontratë me ju): Në këtë rast, ne përdorim të dhënat tuaja personale nëse na duhen për të përmbushur një marrëveshje/kontratë me ju.

Për të përmbushur një detyrim ligjor për HALKBANK. Në disa raste ne si kontrollues kemi detyrimin ligjor të përpunojmë të dhënat tuaja personale, si në rastin kur HALKBANK krijon një marrëdhënie biznesi me ju si klientin tonë në përputhje me ligjin.

Për interesat tona legjitime. Në raste të caktuara, bazuar në analizën e bërë, ne mund të përpunojmë të dhënat tuaja personale aty ku është e nevojshme dhe për interesat tona legjitime në një mënyrë që nuk do të cenojë të drejtat dhe liritë tuaja. Për shembull, është në interesin tonë legjitim të kuptojmë nevojat e vizitorëve të faqes sonë të internetit, të promovojmë shërbimet dhe produktet tona dhe të menaxhojmë në mënyrë efektive faqen tonë të internetit dhe aplikacionet inteligjente për krijimin, publikimin dhe shpërndarjen e përmbajtjes në internet. Shembuj të mbështetjes sonë në interesat tona legjitime në përdorimin e informacionit tuaj personal përfshijnë: analizimin e përmbajtjes që shikohet në faqen tonë të internetit dhe aplikacionet, në mënyrë që ne të kuptojmë se si përdoret dhe të përmirësojmë përmbajtjen e tyre, ose kur analizojmë atë që keni vizituar në faqen tonë të internetit dhe aplikacionet dhe për cilat produkte dhe shërbime keni qenë të interesuar, në mënyrë që të analizojmë dhe përmirësojmë produktet dhe shërbimet tona.

Siguria e të dhënave tuaja personale

HALKBANK zbaton masat e duhura teknike dhe organizative për të garantuar sigurinë e të dhënave tuaja personale nga përpunimi i tyre i paautorizuar ose nga humbja, dëmtimi ose shkatërrimi aksidental. HALKBANK thekson nevojën për të zgjedhur një fjalëkalim të sigurt kur ju kërkojmë të vendosni një fjalëkalim për të hyrë në pjesë të faqes sonë të internetit ose aplikacioneve. HALKBANK rekomandon që ta mbani këtë fjalëkalim konfidencial dhe të zgjidhni një fjalëkalim që nuk do ta përdorni në asnjë faqe tjetër interneti. Ju nuk duhet të ndani fjalëkalimin tuaj me askënd tjetër, duke përfshirë dikë që punon ose pretendon se punon në HALKBANK.

Transferimi i të dhënave personale

Disa nga të dhënat personale që mbledhim për ju mund të transferohen në Grupacionin HALKBANK (Republika e Turqisë), me çrast ne do të vazhdojmë të mbrojmë të dhënat tuaja personale që transferojmë në përputhje me këtë politikë të privatësisë, dokumentacionin e HALKBANK dhe Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale .

Sa herë që ne transferojmë të dhënat tuaja personale, ne sigurojmë mbrojtjen e tyre përmes respektimit të vazhdueshëm dhe aplikimit të masave të duhura mbrojtëse në përputhje me aktet ligjore për mbrojtjen e të dhënave personale që rregullojnë çështjen e transferimit të të dhënave personale.

Cilat janë të drejtat tuaja?

Sipas Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale ju keni të drejtë:

- Të informoheni për përpunimin e të dhënave personale
- Të keni akses në të dhënat personale
- Të korrigjoni dhe fshini të dhënat personale
- Të kufizoni përpunimin e të dhënave personale
- Të kundërshtoni dhe
- Të tranferoni të dhënat

Për informacion shtesë dhe/ose ushtrimin e të drejtave tuaja për mbrojtjen e të dhënave personale, mund të kontaktoni zyrtarin/nëpunësin tonë për mbrojtjen e të dhënave personale Igor Kuzevski në:

e-mail: privacy.officer@halkbank.mk

tel. (02) 3 285 440

Ndryshimi i Politikës së Privatësisë

Politika e privatësisë do të ndryshohet rregullisht në përputhje me ndryshimet e ndodhura dhe aktivitetet tona në përputhje me ligjin.

E juaja,
HALKBANK AD SKOPJE